



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-023
Prishtinë, më 22 shtator 2020, në orën 14:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 SHTATOR 2020

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Kuvendit; Arbërie Nagavci, Kujtim Shala, Memli Krasniqi dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Rexhep Selimi, Arben Gashi, Bedri Hamza dhe Teuta Haxhiu.

Në mbledhje ishin pjesëmarrës:

Nga kabineti i Kryetares së Kuvendit: Faton Peci dhe Artan Murati.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Musli Krasniqi dhe Shefki Shoshaj.

Nga: KDI-ja: Agnesa Haxhiu.

Mbledhjen e kryesoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu.

Kryesia, me propozimin e kryetares, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Pika e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 7, 13, 14 gusht dhe 17 shtator 2020,
2. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 14 gusht dhe 17 shtator 2020,
3. Përgatitjet për seancën e re plenare,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave,
5. Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare - subvencione.

* * *

Në fillim, kryetarja i njoftoi të pranishmit se ndërkohë komisionet parlamentare kanë proceduar materiale për seancë plenare të Kuvendit, të cilat do të shqyrtohen në këtë mbledhje.

* * *

Pastaj, ajo i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit se të premtën, më 25 shtator 2020, ajo së bashku me nënkryetarët e Kuvendit do ta realizojnë një takim me delegacionin e Korporatës për Zhvillim dhe Financim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

* * *

Më pas, kryetarja i njoftoi të pranishmit se nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, ka parashtruar kërkesë që kryeministri të ftohet për të raportuar në Kuvend për 100-ditëshin e punës së Qeverisë.

Ajo tha se do të kontaktohet kryeministri për kohën e raportimit të tij në Kuvend.

Diskutimi i plotë i kryetares është i dhënë në transkript.

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar për ta ftuar kryeministrin që të raportojë në Kuvend për 100-ditëshin e punës së Qeverisë diskutuan: Memli Krasniqi dhe Arbërie Nagavci, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së dhe Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

* * *

Pastaj, kryetarja procedoi me pikat e rendit të ditës:

1. Pika e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 7, 13, 14 gusht dhe 17 shtator 2020

2. Pika e papërfunduar nga Seanca plenare e mbajtur më 14 gusht dhe 17 shtator 2020

3. Përgatitjet për seancën e re plenare

Kryesia i shqyrtoi së bashku pikat 1, 2, dhe 3 të lartshënuara të rendit të ditës dhe pas diskutimeve, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të premtën, më 25 shtator 2020, t'i mbajë dy (2) seanca plenare, si vijon:

I. Vazhdimi i seancave plenare do të mbahet të premtën, më 25 shtator 2020, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

I. Pika e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 7, 13, 14 gusht dhe 17 shtator 2020:

1. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së.

II. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 14 gusht dhe 17 shtator 2020:

1. Votimi në parim i Projektligjit nr.07/L-016 për rimëkëmbjen ekonomike - COVID-19.

III. Pika e papërfunduar nga seanca plenare e mbajtur më 17, 18 dhe 21 shtator 2020:

1. Votimi i propozim-rezolutës nga raportimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi,

2. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, z. Ramë Likaj, sipas kërkesës së nënkryetares së Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci, e nënshkruar edhe nga 7 deputetë tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me përgatitjet për fillimin e vitit shkollor në kushte të pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës,

3. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca e ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së deputetes Fatmire Kollçaku, e nënshkruar edhe nga 9 deputetë tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me hyrjen dhe patrullimin e pjesëtarëve të uniformuar të Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në fshatin Karaçevë të Komunës së Kamenicës,

4. Votimi në parim i Projektligjit për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e pandemisë COVID-19,

5. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me menaxhimin e pandemisë së virusit COVID-19 nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
6. Propozimi i GP të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës,
7. Zëvendësimi i anëtarit në Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me menaxhimin e pandemisë së virusit COVID-19 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

II. Seanca e re plenare e radhës do të mbahet po ashtu të premten, më 25 shtator 2020, në orën 13:00, me këtë:

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i propozim-amendamentit kushtetues nr. 26,
5. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të RTK-së, prej tyre një (1) nga komuniteti serb dhe një (1) nga komunitetet tjera joshumicë,
6. Zgjedhja e Avokatit të Popullit.

Po ashtu, në lidhje me pikën 5 të lartshënuar, Kryesia, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohe nga grupet parlamentare të Kuvendit që para se të mbahet seanca plenare më 25. 9. 2020, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, prej tyre: një (1) nga komuniteti serb dhe një (1) nga komunitetet tjera joshumicë.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LVV-së, 3 anëtarë (kryetarin dhe 2 anëtarë); GP i LDK-së, 3 anëtarë (nënkryetarin e parë dhe 2 anëtarë); GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP i Listës serbe, nënkryetarin e dytë dhe GP 6+, 1 anëtar.

* * *

Kryesia, në lidhje me përgatitjet për seancën e re plenare, për dy (2) pikat e rendit të ditës të paraparë për këtë seancë, vendosi si në vijim:

- Zëvendësimi i anëtarit në Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me menaxhimin e pandemisë së virusit COVID-19 nga Qeveria e Republikës së Kosovës u bart te rendi i ditës në vazhdimin e seancës plenare: *III. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 17, 18 dhe 21 shtator 2020.*

- Propozimet e (4) katër komisioneve parlamentare për ndryshimin e emërtimeve dhe fushëveprimtarive të tyre shtyhen për një seancë tjetër me qëllim të përfshirjes së propozimeve edhe nga komisionet tjera.

* * *

Kryesia, në lidhje me deklaratimet jashtë rendit të ditës të seancave plenare të Kuvendit, me qëllim të harmonizimit të kohës, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që së bashku koha për deklaratimet jashtë rendit të ditës e përcaktuar për deputetët nga neni 47 dhe koha për deklaratimet e ministrave nga neni 48 të Rregullores së Kuvendit të jetë prej një (1) ore.

* * *

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Nisma legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Nismën legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

2. Informatë e Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes në lidhje me kërkesën e z. Bujar Sadiku, drejtor i Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Kryetarja i njoftoi të pranishmit se Komisioni Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes e ka shqyrtuar kërkesën e z. Bujar Sadiku, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Informim dhe Privatësi, për autorizimin e tij për kryerjen e disa veprimeve, por ky komision ka ardhur në përfundim se trajtimi i kësaj çështjeje nuk është në kompetencë të tyre dhe kërkesën e kanë proceduar për informim në Kryesinë e Kuvendit.

Në lidhje me informatën e lartshënuar diskutuan: kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu; Memli Krasniqi dhe Arbërie Nagavci, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së dhe Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, në lidhje me informatën e lartshënuar të Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Kryesia nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit nuk është kompetente për dhënien e autorizimit të veçantë për drejtorin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, z. Bujar Sadiku.

Kuvendi të shpallë konkursin për zgjedhjen e Komisionarit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Kryesia e Kuvendit e inkurajon Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes që të ndërmarrë Nismë legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Kërkesë nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës

Kryetarja i njoftoi të pranishmit me kërkesën e Klubit të Prodhuesve të Kosovës, i cili klub ka kërkuar mbështetje që Kuvendi i Kosovës ta miratojë një rezolutë për përkrahjen e prodhuesve vendorë.

Ajo po ashtu kërkoi nga të pranishmit që t'i përgatisin propozimet e tyre dhe më pas të propozohet sipas Rregullores së Kuvendit për miratim një propozim-rezolute për përkrahjen e prodhuesve vendorë.

Diskutimi i plotë i kryetares është i dhënë në transkript.

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar, diskutuan: Bedri Hamza, në emër të GP të PDK-së dhe Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së, si dhe kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, kryetarja tha se nëse përgatitet me kohë propozim-rezoluta, ajo mund të paraqitet për miratim në seancën plenare të Kuvendit, të premtën, më 25 shtator 2020.

4. Kërkesa e Komisionit ad hoc, për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për shtatë (7) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i formuar nga Kuvendi i Kosovës, me vendimin nr. 07-V-024, datë 10. 7. 2020, i lejohen mjete financiare shtesë në shumën prej 500,00 (pesëqind) euro.

5. Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare-subvencione

1. Kërkesa e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, mbështetet financiarisht në shumën prej 4 600 (katërmijë e gjashtëqind euro), për financimin e aktiviteteve të këtij Këshilli në monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria, përkatësisht të ndaluar, të paraburgosur dhe të dënuar.

2. Me shumën e lejuar nga pika një (1) e këtij vendimi nuk mbulohen shpenzimet e parapara në tabelën e buxhetit pika 2.2 në kërkesën e parashtruesit.

Të ndryshme:

Në fund, Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së kërkoi që të përmirësohet sistemi i zërimit në sallën e seancave plenare.

Kryetarja e Kuvendit e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:48 minuta.

Vjosa Osmani - SADRIU

Kryetare e Kuvendit

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*